



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr.1084/1Prot.

Shkodër, më 29.01.2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Rruga: _____

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 33, datë 22. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 1084, datë 23. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Qendrat Komunitare “Për Familjen” të ngritura dhe vëna në funksion nga Bashkia e Shkodrës, ofrojnë shërbime parashoqërore dhe shoqërore për familjet në vështirësi socio-ekonomike. Pjesë e përfituesve të këtyre shërbimeve janë familje, viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare. Shërbimet e ofruara pranë qendrave komunitare kanë rol parandalues dhe trajtues, sipas nevojave specifike që paraqet çdo rast.

Sa i përket qendrave për trajtimin dhe rehabilitimin e dhunuesve, për informacionin tuaj, në të gjithë territorin e Shqipërisë janë 2 qendra të tilla, të ngritura nga organizata të shoqërisë civile; “Linja e Këshillimit për djem dhe burra”, pjesë e shërbimeve plotësuese së “Këshillimit për gra dhe vajza”, në Tiranë dhe “Zyra për djem dhe burra”, pjesë e shërbimeve të “Gruaja te Gruaja”, në Shkodër.

Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2017, në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar) neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Pjesë e kësaj marrëveshjeje janë “Gruaja te Gruaja” dhe “Zyra për djem dhe burra”, me të cilat koordinojmë shërbimet për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

KRYETAR

Voltana Ademi
